

Procesi i prodhimit në Fabrikën e armaturave të ndërtimtarisë fillon me tërheqjen e telit të ftohët nga pazmat e lëmuara në tel të çelikut të lëmuar apo brinjëzuar me përmisimin e vetive mekanike deri në 50%.

Rrjetat e salduara të armaturës përbëhen nga telat (shufrat) e çelikut të vendosura në dy rrafshet paralele.

Telat e njërit rrafsh janë gjatësore dhe në mes veti paralele, ndërsa telat e rrafshit tjetër janë tërthore dhe poashtu paralele në mes veti.


Telat gjatësore dhe tërthore në mes veti kryqëzohen në këndin e drejtë dhe ngjiten me anën e saldimit me elektrozistencë.

RRJETAT STATIKE


Rrjetat statike si shufra mbartëse mund të kenë ato gjatësore ose tërthore ose edhe gjatësoret edhe tërthoret tek admirimi në dy drejtime. Punohen në pllaka të rrafështa me diametra të shufrave $\varnothing 4.0 - 10.0$ (mm)

Në figurë janë paraqitur tipat e rrjetave që më së tepërmi dallohen:

- TIPI R, rrjetë për mbartje gjatësore
- Tipi Q, rrjetë për mbartje të dy anshme.



R - rrjeta



Q - rrjeta

RRJETAT STANDARDE (TIPIKE)

Rrjetat standarde punohen në pllaka me gjerësi B=2000 (mm) gjatësi L=6000 (mm)

Dimensionet e rrjetave mund të punohen me trashësi nga $\varnothing$ 4.5 deri në diametrin D 10 mm.

FUSHAT E APLIKIMIT TË ARMATURËS RRJETORE

Rrjetat e salduara të armaturës përdoren në ndërtimtari si armaturë për elemente të llojllojshme të betonarmesë

Aplikohen në ndërtimtarinë e lartë dhe të ulët për amirimin e elementeve të ngarkuara për lakim në një apo dy dretime kryesisht për ngarkesë statike,

Në ndërtimtarinë e lartë

- ▶ Pllakat monolite dhe montazhe të konstruksioneve meskatëshe
- ▶ Pllakat e admiruara kryesore
- ▶ Tavanet në formë këpurdhe
- ▶ Siloset
- ▶ Kulmet e hallave të shtrira lehtë
- ▶ Muret e rrafshëta të beton – admiruara
- ▶ Dyshemetë e hallave industriale
- ▶ Rezervuare
- ▶ Basene

Në ndërtimtarinë e ulët

- ▶ Muret mbështetëse (ndihmëse)
- ▶ Tunelet, kanalet, kolektorët, vendkalimet nëntokësore
- ▶ Sipërfaqet sportive
- ▶ Rugët (të betonuara dhe të asfaltuara) – pista aeroportesh
- ▶ Pllato për qëllime të ndryshme etj.

PËRPARËSITË NË TË APLIKUAR

Me përdorimin e rrjetave të salduara të armaturës lehtësohet puna gjatë projektimit, ndërsa gjatë ndërtimit kursehet në kohë.

Thjeshtësohen punët klasike armiruese si: drejtimi, prerja, lakimi i lëndëve, lidhja, si dhe disa operacione tjera që janë të domosdoshme në rastin e armaturës klasike, kështu që e tërë puna kryhet me vendosjen e rrjetës.

Kualiteti i kësaj armature është i garantuar me kontrollën e përhershme gjatë prodhimit të saj në pajtimet më bashkëkohore.

Me aplikimin e armaturës rrjetore nga teli i tërhequr (petëzuar) në të ftohet arrijmë të kursejmë edhe atë:

a) Në material

- ▶ çelik për betonim
- ▶ tel për lidhje
- ▶ energji elektrike

b) Në kohë

- ▶ Nga parafabrikimi i armaturës rrjetore bien përpunimi dhe vendsoja në krahasim me kohën e nevojshme për përpunimin dhe vendosjen e armaturës klasike.